



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Nr. 57

Datë: 03. 09. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvij, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef. ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.
2. Aktivitetet e ZRPPC-së:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për decertifikim të kandidatëve për zgjedhjet lokale 2021,
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve për zgjedhjet lokale 2021.
- 3 Të ndryshme

1.Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: Po fillojmë mbledhjen e 57-të të KQZ-së, nw rend të ditës janë aktivitetet e zyrës me dy çështje për miratim dhe, të ndryshme! A pajtoheni me rendin e ditës qw e keni pwrpara?

Ylli Buleshkaj : Dje, na ka mbetë një pikë e cila për shkak të listës së vëzhguesve nuk ishte në shqyrtim, prandaj kërkoj që e njëjta që jetë sot dhe të shqyrtohet, e po ashtu, edhe miratimi për akreditim të vëzhguesve. Edhe një pikë tjetër, nëse është e mundur: të aprovohet udhëzuesi për tërheqjen e shortit i cili, do të mbahet të mërkurën e ardhshme...

Kreshnik Radoniqi: A keni diçka me deklaruar lidhur me këtë dhe, dy propozimet tjera ?
A pajtoheni me rendin e ditës ?

Miratohet rendi i ditës me 10 vota.

2. Aktivitetet e ZRPC-së:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për decertifikim të kandidatëve për zgjedhjet lokale 2021:

Ylli Buleshkaj: Me 1 shtator e kemi pranuar një aktgjykim nga Gjykata e Apelit me të cilin është vërtetuar vendimi ndaj dy kandidatëve të cilët kanë qenë të certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje për komunën e Klinës: fjala është për z. Sokol Bashota i cili, ka qenë kandidat për kryetar komune dhe z. Enver Berisha i cili ka qenë kandidat për asamble. Neni 29 pika e 4, e parasheh se në qoftëse dikush e humb aftësinë për të qenë kandidat atëherë, KQZ i decertifikon ata kandidatë. Rrjedhimisht, rekomandojmë që këta të dy kandidatë të certifikohen. Sa për informatë, pasi që e kemi marrë përgjigjen, ne e kemi informuar edhe partinë politike...Dhe, si pikë e radhës, është edhe zëvendësimi i këtyre dy kandidatëve...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit Ylli, a ka dikush diçka lidhur me këtë çështje? Atëherë e hedhim në votim: kush është për certifikimin e kandidatëve sipas rekomandimit të zyrës?

Më 10 vota për, miratohet rekomandimi i zyrës për certifikimin e kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës. Për kryetar komune z. Sokol Bashota, dhe për Kuvend Komunal z. Enver Berisha.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve për zgjedhjet lokale 2021:

Ylli Buleshkaj: Si pikë e radhës, është shqyrtimi dhe miratimi për certifikim të kandidatëve për zgjedhjet lokale 2021. Për shkak të tërheqjeve nga listat e kandidatëve dhe pastaj, telasheve me kuotën gjinore atëherë subjekteve politike ju është dhënë

mundësia që të plotësoj vendet të cilat kanë shkaktuar telashe në radhitjen në kuotën gjinore më këtë arsye e kemi një sere rekomandimesh për këto duke e përfshi edhe rekomandimin që e ceka ma herët.

Kreshnik Radoniqi : Mirë a shkojmë një nga një...?

Ylli Buleshkaj: Rekomandojmë për certifikim të tre kandidateve të VV, një kandidat është për kuvend komunal të Mitrovicës së Jugut, Faheri Beqiri. Një kandidate është për kuvendin komunal të Shtimes, dhe një kandidate tjetër është për kuvendin komunal të Skenderajt. Numri total i i kandidateve i cili është votuar më certifikimin e partive politike është i njëjte, nuk ndryshon por vetëm bwhet zëvendësimi i tyre.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush ka diçka me deklaruar lidhur më këtë. Nwse jo, e hedhim në votim. Kush është për?

Me 10 vota për, aprovohet rekomandimi për certifikime të kandidateve të partisë politike Lëvizja Vetëvendosje sipas rekomandimit të sa po lexuar.

Ylli Buleshkaj: Rekomandimi i radhës i zyres është për certifikimin e kandidateve të zëvendësuar nga Partia Demokratike e Kosovës, si ne vijim: z. Esat Rraci kandidat për kryetare në komunën e Klinës, z. Bledar Berisha kandidat për kuvend komunal tw Klinës. I kemi edhe dy kandidate të tjerw: Artane Bytyqi, kandidate për kuvendin komunal të Suharekës, dhe Mimoza Hamiti kandidate për kuvend komunal të Obiliqit.

Pwr të gjitha këto kandidaturat tw reja, duke e përfshirw edhe ato paraprakisht, janë kryer të gjitha verifikimet, duke e përfshi edhe verifikimet e KGJK-së...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit Yll. Atëherë nëse nuk ka dikush diçka me deklaruar, e hedhim në votim. Kush është për aprovimin e këtij rekomandimi ?

Me 10 vota për, aprovohet rekomandimi për certifikim të kandidateve të partisë politike PDK-së në zgjedhjet lokale 2021. Të katwr kandidatët e sapo prezantuar nga z. Buleshkaj.

Ylli Buleshkaj: Tash kalojmë të nënpika e tretë të pikës së dytë e që i bie “rekomandim për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës”. Ashtu sikur edhe dje, nw vijim ne rekomandojmë që të akreditohen vëzhguesit e medias lokale “Viminfodo”, duke përfshi edhe listën e tyre që e keni të bashkangjitur...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit e trajtuam këtë çështje dje a ka dikush diçka me deklaruar? Domethwnw nuk ka, atwherw e hedh në votim kwtw rekomandim. Kush është për ?

Me 10 vota për, aprovohet rekomandimi për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet lokale në republikën e Kosovës 17 tetor për pesë (5) vëzhgues.

Ylli Buleshkaj: Pika e radhës është “udhëzuesi për tërheqjen e shortit”. Pra, ashtu sic e parasheh ligji, kryesuesi i KQZ-së është përgjegjës për mbarëvajtjen e tërheqjes së shortit. Për shkak të operacionalizimit të nenit i cili e mbulon kështu evenimentin zgjedhor, përgatitet në mënyrë tradicionale një udhëzues i cili e qartëson secilin hap që duhet të ndërmerret. Këtu para jush, e keni udhëzuesin i cili e parasheh duke përfshirë edhe datën kur mbahet tërheqja e shortit, e që është 8 shtatori; procedura se si do të ndiqet është e njëjta me dy palë zgjedhjet e fundit. E keni të bashkangjitur edhe ftesën e cila do të ju dërgohet subjekteve politike por, edhe agjendën e cila parashihet që të dorëzohet pasi që të aprovohet. Si lokacion ku do të bëhet tërheqja e shortit, e kemi të rezervuar amfiteatrin e qeverisë së Republikës së Kosovës në ndërtesën e ish Rilindjes sepse, ka shumë hapësirë...

Kreshnik Radoniqi: Urdheroni z. Elshani ?

Arianit Elshani: Një pyetje e kam: sa subjekte janë të certifikuar në total deri me sot ? Ka përfunduar afati por, në total sa është numri i iniciativave dhe i kandidatëve të pavarur dhe subjekteve në garë për kuvend komunal edhe për kryetar ?

Ylli Buleshkaj: Po, është e vërtetë të gjitha subjektet politike të cilat pa marrë parasysh që kanë aplikuar për kryetar komune apo për kuvende komunale, e marrin numrin e tyre edhe në çiftë se kanë kandidat edhe vetëm për një komunë të vetme...Janë 90 subjekte që do të tërhiqen, aktualisht ka afat deri më 6 shtator, me gjasë numrat që do të tërhiqen do të jenë mes 111 – 200, nëse nuk ndodh diçka e veçantë...

Florian Dushi: Për drejtorin, e kisha një pyetje: shorti organizohet për tërheqjen e të subjekteve politike të pika I po thotë zyrtari i sekretariatit duhet të e tërheqë topat në emër të subjekteve politike të certifikuar dhe kështu cakton radhën tek pjesa radha e subjekteve për të tërhequr shortin.

Ylli Buleshkaj: Si hap i parë, është zyrtari i Sekretariatit të tërhequr një top me emrin e subjektit politik, pastaj del përfaqësuesi i subjektit politik i cili, e tërheq numrin për subjektin e tij...

Alim Rama: Një pyetje për drejtorin ,unë po e shoh këtu që shorti fillon me numrin 111 dhe kjo është praktika për zgjedhjet nacionale, numri më i madh i kandidatëve për asamble është(nuk dëgjohet), do të kërkoja që numrat e subjekteve mos me qenë të njëjta me numrat e kandidatëve...

Ylli Buleshkaj: Kjo, është vetëm një vazhdimësi, praktikë, ashtu e filluar edhe për zgjedhjet lokale dhe qendrore. Kur kemi mbajtur mbledhje në një komunë, si në Mitrovicën e Veriut, ne prapë jemi shkuar me këtë numrin 111 e tutje. Wshtë praktikë, nuk ceket në ligj...! Ne, mund të fillojmë edhe nga numri 56, në qoftë se vendosni ju: komuna e Prishtinës i ka 55 maksimumi, atëherë mund të fillojmë nga 56, por në mënyrë që të ketë një vazhdimësi dhe një logjikë, atëherë nuk po besoj që është ndonjë telashe...

Alim Rama: Jo unë e kuptova ,kur the numri i fundit ka me qenë 200 është mirë mbi të gjitha me qenë me 100 ,le të jetë 102 le të jete 105 cilido që është numri i parë për mos me kaluar në mëdyshje dikush se ai identifikohet ndaras...

Arianit Elshani: Është vendosur një standard i mirë prej zgjedhjeve të 2019-tës, kur numrat e subjekteve politike janë mbi numrin 101 pra mbi numrin e fundit që është 110 për kandidatë sepse, ka pasur raste kur qytetarët kanë votuar gabimisht edhe për kandidatin me atë numër të subjektit politik, pra 58 - shin prapë ka mund të ndodhë që në dy anët e ka bërë, pra nuk ka qenë votë realisht për deputetin por ndoshta për subjektin politik por ka ndodhur ky ngatërrim...Kjo është arsyeja që, është vendosur mbi 111, pra me 110 përfundon numri i kandidatëve për deputetë dhe kërkesa që të jetë mbi 56, është që po ashtu 56-shi është numri i fundit i një anëtari të kuvendit komunal, një kandidati në fletëvotim dhe që të jetë reale secila votë! Kjo është arsyeja pse ka vendosur mbi atë, dhe tash patëm propozimin që të jetë mbi 111 që jam dakord, sepse përfundon me 200 në fund...

Kjo, është çështje që duhet të rregullohet me rregullin e brendshwm për fletëvotime ku caktohen këta numra dhe, njëherë e mirë, të rregullohet kjo çështje edhe për kandidatët për asamble komunale mirëpo, edhe për deputetët sepse së paku unë jam i interesuar pas miratimit të fletëvotimeve lidhur me numrat rendorë... Nuk e di bazën, e di precedanin që është vendosur dhe e vlerësoj shumë, është një standard i mirë që secila votë të jetë votë reale dhe të mos ngatërrohet votuesi tek sa voton në zgjedhje prandaj, mbështesw propozimin që të jetë nga numri 101 për subjektet politike në garë për komunë dhe kuvende komunale, dhe në 111 e sipër për zgjedhjet parlamentare...

Kreshnik Radoniqi: A po pajtoheni të gjithë që me qenë prej “101”...?

Miratohet...

